

TEKSTILET

Vend me rëndësi në ekspozitën etnologjike zënë edhe tekstilet. Numrin më të madh të tyre e përbëjnë punëdoret e imta, të punuara, kryesisht, me grep e gjilpërë. Të gjitha këto eksponate janë interesante, si për nga materiali e teknika e punimit, ashtu edhe nga ornamentika që, herë-herë, të çon në lashtësi, tek të parët tanë-Iliret.

EKSPOZITA ARKEOLOGJIKE

Ekspozita arkeologjike, e hapur në vitin 2014, paraqet trashëgiminë arkeologjike të Rajonit të Pejës. Artefaktet e prezentuara janë gjetur në lokalitetet arkeologjike të Pejës me rrethinë. Ato u përkasin periudhave të ndryshme kohore, duke u nisur nga parahistoria, antikiteti, mesjeta, periudha osmane e deri në kohërat moderne.

STELA E CIPUSI

Janë monumente mbivarrore të gjetura në fund të vitete të '70 në lokalitetin arkeologjik 'Gradina', pranë Fabrikës së Baterive dhe i përkasin shek. II të erës sone.

MONEDHAT

Monedhat e prezentuara në ekspozitën arkeologjike u takojnë periudhave të ndryshme kohore duke u nisur nga periudha e Dardanisë Urbane, Mesjeta, Periudha Austro-hungareze, ajo Osmane e deri në kohërat modern.

LLAMBA VAJI

Llambat vaji janë gjetur në Pejë dhe u takojnë shek. II-III.



PEJA

Peja shtrihet në perëndim të Kosovës dhe kufizohet me Deçanin, Klinën dhe Istogun përbrenda Kosovës, ndërsa me kufij shtetëror kufizohet me shtetin e Malit të Zi. Lartësia mbidetare në qytet sillet nga 520-550 m, ndërsa pika më e lartë është maja malore e Gurit të Kuq 2522 m. Kryeqyteti Prishtina gjendet 86km larg nga Peja.

Aritshmëria në qytetin e Pejës mund të bëhet përmes transportit rrugor dhe hekurudhor që janë mjaft të shfrytëzueshme, ndërsa me transport ajror nga Aeroporti ndërkombëtar Adem Jashari i cili gjindet 70km larg nga Peja.



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEĆ

Drejtorati për Zhvillim Ekonomik - Sektori i Turizmit
Directorate for Economic Development - Tourism Sector
Direktorat za ekonomski razvoj - Sektor za turizam
www.pejaturism.org | pejaturism@yahoo.com | +381 39 423 949
Rr. / Str : Mbretëresha Teuta No.59 | 30000 Peja



MUZEU I PEJËS / MUSEUM OF PEJA

039/431-976 • 049/ 766 757
Adresa: Sheshi "Haxhi Zeka"



MUZEU I PEJËS



MUZEU I PEJËS

Muzeu i Pejës, i vendosur në 'Konakun e Tahir Beut', prezenton trashëgiminë kulturore të Rajonit të Pejës. Posedon rrethi 700 eksponate etnologjike, prej të cilave 450 janë të ekspozuara në ekspozitën 'Trashëgimia Kulturore e Rajonit të Pejës', dhe 100 artefakte arkeologjike të ekspozuara në ekspozitën 'Trashëgimia Kulturore Arkeologjike'. Kjo pasuri tregon traditën dhe kulturën e begatë të trevës sonë dhe numrin e madh të zejeve që kanë vepruar në këtë Regjion.



'KONAKU I TAHIR BEUT' (shek. XVIII)

Është ndër ekzemplaret më të bukur të shtëpive të vjetra qytetare të tipit asimetrik ku akoma ruhen mirë dollapet e murit, tavani i punuar nga drurit, dyert dhe dritaret, si dhe dyshemeja prej dërrasave. Si i tillë paraqet një objekt me rëndësi kulturore, si në aspektin arkitektonik ashtu edhe në atë etnologjik.

EKSPOZITA ETNOLOGJIKE

Ekspozita etnologjike prezenton trashëgiminë shpirtërore dhe materiale të trevës së Dukagjinit të shek. XIX-XX, nëpërmjet koleksioneve të veshjeve, stolive, enëve, veglave të punës, instrumenteve muzikore, tekstillit, shtrojes, etj.

KOSTUMET TRADICIONALE

Kostumet e prezantuara në ekspozitë shquhen për shprehje artistike, veçmas për pasuri ornamentale e kromatike, si dhe me funksionin e tyre praktik e shoqëror. Në këtë koleksionin bëjnë pjesë veshja e Rrafshit të Dukagjinit, veshja e Rugovës, e nuseve të qytetit me dimi dhe veshja e burrave me tirq.



STOLITË

Stolitë e prezentuara në ekspozit janë të punuara, kryesisht prej argjendi, në forma, madhësi dhe teknika të ndryshme zbukurimi. Numrin më të madh të tyre e përbëjnë stolitë e femrave, si: unaza, vathë, qafore, byzylykë, gjerdanë etj. ndërsa stolitë e burrave janë: qostekë, kuti duhani, çibuku e pipa, të zbukuruara me tekniken e granulimit, filigranit dhe savatit.



VEGLAT E PUNES

Veglrat e punës, më tepër janë të përfaqësuara me ato që kanë të bëjnë me përpunimin e leshit si: veku, furka, shtiza, boshte, çikrikë, gërhanë etj. Këto eksponate janë të punuara me një mjeshteri të rrallë nga dora e mjeshterve tanë madje edhe me mjete fare të thjeshta.

ARMËT

Ndër eksponatet tjera që vlen të permenden janë edhe armët. Ato u takojnë shek. XVIII, XIX e XX. Janë të punuara dhe të zbukuruara me një mjeshtëri të rallë nga mjeshtrit tonë popullorë. Prej armëve të 'ftohta' apo të 'bardha', paraqiten jatagani e thika, ndërsa prej atyre të zjarrit pushka e gjatë me emrin 'karajfile', pastaj vezme, palcore, thupra baroti, etj.

MUZIKA DHE INSTRUMENTET

Muzika dhe instrumentet muzikore në Muzeun e Pejës si: defi, çiftelia e lahuta, kanë qenë një nga pikat kulturore që janë kultivuar në trevën tonë.

Njihen këngët e vjetra qytetare që këndoheshin në tubime gazmore, si dhe ato folklorike e rapsodike, të cilat ishin të lidhura me situatat aktuale të kohës. Lahuta, si instrument i lashtë, edhe sot e kësaj dite përdoret në Rajonin e Pejës, veçmas në Regjionin e Rugovës.

